



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Autoriteti Kosovar i Konkurrencës**

**Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority**

Datë: 12.02.2018

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës mbështetur në nenin 28, nenin 29 paragrafi (1), nenin 54, paragrafi (2) me nën paragrafin 2.3, neni 3 paragrafi (1.8), neni 34, nenin 35 paragrafi (5) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare Nr. 88/25), dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës si dhe Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative sipas kërkesës së Grupit KOHA Sh.p.k. me pretendimin e tyre për abuzim me pozitën dominuese në tregun e platformës digjitale kabllore nga IPKO Telecommunications Sh.p.k. në mbledhjen e mbajtur me datën 12.02.2018 merr këtë:

### KONKLUZION

- I. Bazuar në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit të situatës në tregun relevant, konstatojmë se nuk ka argumente për Fillimin e Procedurës Hetimore ndaj IPKO Telecommunications Sh.p.k. në tregun e Platformës Digjitale Kabllore.
- II. Ky konkluzion hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.

### ARSYETIM

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me datën 20.05.2013, në shkresën me numër të Prot. 83/13, ka pranuar kërkesën nga kompania Grupi KOHA Sh.p.k, për Fillimin e Procedurës Hetimore kundër IPKO Telecommunications sh.p.k, me pretendim për Keqpërdorim të Pozitës Dominuese në Tregun e Platformës Digjitale Kabllore. Në kohën kur është dorëzuar kërkesa e Grupi KOHA Autoriteti Kosovar i Konkurrencës nuk e kishte funksional Komisionin, si organ vendimmarrës, e me këtë rrjedhimisht ka qenë e pa mundur për të ndërmarrë veprime ligjore lidhur me këtë çështje. Me datën 27.04.2017, me numër të Prot. 95/17-01/H, është bërë ri iniciimi i kërkesës nga Grupi KOHA.

Pretendimet e palës ankuese të Grupit KOHA Sh.p.k, janë se: IPKO Telecommunications Sh.p.k, ka pozitën dominuese në Tregun e Platformës Digjitale Kabllore duke u bazuar në neni 10 paragrafi 2 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe se është duke e Keqpërdor Pozitën e saj Dominuese në treg duke u bazuar në neni 11 paragrafët 1.2. dhe 1.3, të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës me arsyetimin se *zhvendosja e kanalit të KTV-së nga kanali 3 në kanalin 83. ka vendosur KTV, në pozitë të disfavourshme me RTV 21, i cili është konkurrent i vetëm i televizionit Koha Vision - KTV në tregun e televizioneve private me frekuencë kombëtare dhe televizione tjera.*

## TREGU PËRKATËS APO RELEVANT

**Tregu gjeografik** - duke iu referuar nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës Nr. 02/2011, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu **gjeografik është konsideruar territori i Republikës së Kosovës.**

### **Tregu i produktit është:**

- Ofrimi i shërbimeve nga IPKO Telecommunications Sh.p.k. në platformën digjitale kabllore.

### **Vlerësimi i të dhënave gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit dhe analiza e konkurrencës**

Më datën 15.03.2013, IPKO kishte pranuar një shkresë nga KTV, e cila kishte kërkuar kompensim monetar në lartësi prej 10 mijë euro për muaj, që nga data 1 prill 2013, **në këmbim të emetimit të programit të "Kohavision"** përmes të cilës, KTV kishte kërkuar pagesë për bartje, në të kundërtën kërkonte të tërhiqej nga platforma digjitale kabllore në rast se kërkesa e KTV-së nuk pranohet nga IPKO-ja.

Me datën 28.03.2013 IPKO ishte përgjigjur në letrën në fjalë duke mos u pajtuar me kërkesën e KTV-së, dhe e njëjta kishte shprehur keqardhje ndaj vendimit të saj për tërheqje nga platforma në rast se propozimi i KTV-së nuk pranohet nga IPKO.

IPKO-ja në atë periudhë kohore kishte bërë ri renditjen e kanaleve duke marrë parasysh mos-interesimin e KTV-së për të qenë pjesë e platformës dhe në përputhje me rregulloren e KPM-së, e cila nuk parashihte ndonjë detyrim për IPKO-në, që kanalin televiziv KTV ta vendoste në ndonjë numër brenda platformës. Me rastin e mos marrëveshjes për shkak të pagesës së kërkuar nga KTV, IPKO në momentin e ri renditjes së kanaleve nuk e kishte larguar KTV-në nga platforma e saj digjitale kabllore por e kishte ri renditur nga numri rendor i kanaleve televizive nga 03 në 83.

Me datën 12.04.2013, IPKO kishte pranuar shkresë nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), me anë të së cilës kërkon nga IPKO respektimin e Rregullores së atëhershme për Distribucionin Kabllor e cila ka paraparë obligimin e operatorëve kabllorë për njoftim të KPM-së për shtim apo largim të kanaleve. Me datë 15.04.2013, IPKO i është përgjigjur KPM-së duke konsideruar që nuk ka bërë shkelje të dispozitave të Rregullores së KPM-së si dhe kushteve të licencës, sepse në rastin në fjalë IPKO nuk kishte bërë largim apo shtim të kanalit, por vetëm ri renditje të kanaleve.

IPKO me datë 19.04.2013, kishte kërkuar nga KPM që të bëjë sqarime urgjente për opinionin në lidhje me Komunikatën e lëshuar me datën 12.04.2013. Më datën 25.04.2013 KPM-ja kishte sqaruar për opinionin duke shpjeguar që asnjë Rregullore e KPM-së nuk është shkelur nga ana e IPKO-së.

Në Rregulloren CIMC-2007/04 (e KPM-së) për distribuimin kabllor të programeve Radio Televizive në Kosovë në fuqi në atë kohë, nuk kishte parashikuar ndonjë obligim për operatorët kabllor që t'i paguajnë televizionet për bartje në platformën e një operatori kabllor, rrjedhimisht IPKO nuk kishte detyrim kontraktual ndaj KTV-së në lidhje me numrin dhe vendin që ky kanal duhej të kishte në platformën e saj e po ashtu as ndonjë obligimi financiar.

Në bazë të Rregullores CIMC-2016/01, e Distribuimit Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, neni 17 i kësaj Rregulloreje Operatorin kabllor e obligon që ta themelojë Këshillin Programor dhe i cili në pajtim me këtë Rregullore dhe me kapacitete teknike të operatorit të shpërndarjes do të vendos se cilat Radio ose TV programe do të ofrohen në operatorin e shpërndarjes.

IPKO Telecommunications Sh.p.k. me datën 22.09.2016 kishte marrë vendim me të cilin kishte themeluar Komisionin Programor, duke u bazuar në Rregulloren e KPM-së Nr. KPM-2016/01 për distribuim e shërbime mediale, audio dhe audio-vizuele. Në këtë vendim të IPKO-së përcaktohen detyrat e këtij komisioni, siç janë: shqyrtimin e kërkesave, vendosjen se cilët televizione do të janë pjesë e platformës së IPKO-së, përgatitjen e ofertave për televizione, të menaxhoj listën zyrtare të kanaleve të platformës së IPKO-së, etj.

Në Rregulloren e KPM-së Nr. CIMC-2007/04, për distribuimin kabllor të programeve Radio Televizive në Kosovë e vitit 2007 nuk ka përcaktuar e as nuk ka përmbajtur ndonjë obligim për operatorët kabllor lidhur me renditjen e kanaleve.

Në bazë të Rregullosës së KPM-së CIMC-2016/01 për Distribuimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, neni 11, Këshilli Programor i të Licencuarit do të vendos për renditjen e kanaleve të para në kategorinë e programeve të shpërndara nga i licencuari, ku në fillim renditen dy kanalet televizive të Transmetuesit Publik RTK1 dhe RTK2. Kompania IPKO Telecommunications Sh.p.k, ka bërë renditjen e kanaleve me të cilin dy transmetuesit publik janë të renditur në nr. rendor RTK1 në nr. 02 dhe RTK2 në nr. rendor 03.

IPKO e kishte në dispozicion manualin për krijimin e listës favorite të kanaleve në resiverin **KAON**. Resiveri **KAON** është lloji i resiverit të parë që IPKO ka pasur në dispozicion nga fillimi i shpërndarjes së kanaleve. Tani përveç këtij lloji, IPKO ofron edhe dy lloje tjera të resiverëve, **Smart Box dhe GLEE**, të cilët ju mundëson abonuesit krijimin e listës favorite. Dallimi në mes tyre qëndron që tek resiverët **KAON** lista e re ruan numrin rendor të kanalit televiziv, ndërsa tek resiverët **Smart Box e GLEE** nuk paraqitet numri i kanalit nga lista origjinale.

Gjatë analizimit të dokumentacionit dhe infrastrukturës ligjore, Autoriteti ka konstatuar se nuk ka argumente për fillimin e procedurës hetimore ndaj IPKO Telecommunications Sh.p.k. për faktin se nuk ka argumente se IPKO në vitin 2013 ka keqpërdorur pozitën e saj dominuese në tregun përkatës e cila e kishte ri renditur kanalën e KTV-së nga nr. rendor 03 në 83.

Renditja e kanalit televiziv KTV-së në nr. 83, nuk kishte ndikuar në çrregullimin e konkurrencës në tregun përkatës, për shkak se klienti apo abonuesi i platformës digjitale kabllore të IPKO-së ka pasur mundësi ligjore dhe teknike pa pengesë t'i shikoj të gjitha kanalet televizive si dhe të krijoj Listën Favorite të shikueshmërisë sipas preferencës së abonuesit.

Në bazë të dispozitave të Rregullosës së KPM-së CIMC-2007/04, për Distribuimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, nuk e obligonte asnjë operator kabllor që paraprakisht kanalet televizive t'i rendit sipas kësaj Rregulloreje mirëpo i jepet si kompetencë që Këshilli Programor i operatorit kabllor të bëjë renditjen e kanaleve televizive duke u bazuar në ofertën dhe kërkesën në treg.

Gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit dhe situatës në tregun përkatës Autoriteti ka vlerësuar se ri renditja e kanaleve televizive nga ana e IPKO Telecommunications Sh.p.k. është bërë në suaza të fushëveprimit të saj si kompani dhe ka cilësuar se këto veprime nuk e kanë dëmtuar KTV-në si televizion nacional e me këtë as konkurrencën aktuale dhe potenciale në raport me televizionet tjera në tregun relevant.

Në bazë të shërbimeve që ka ofruar IPKO përmes resiverëve Kaon, Smart box dhe GLEE abonuesi ka pas mundësin të krijojë Listën Favorite të kanaleve. Nga analiza e konkurrencës është konstatuar se KTV si



televizion nuk është dëmtuar shikueshmëria e as abonuesi i cili e ka pas mundësin ta ketë KTV-në në Listën e vet preferenciale të shikueshmërisë.

Sipas evidencës së të dhënave dhe cilësimit të kësaj sjellje të IPKO-së në treg, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës duke u bazuar në nenin 35 paragrafi 5 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës vlerëson se nuk ka argumente për fillimin e procedurës hetimore dhe u vendos si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

**Këshilla juridike:** Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të inicioj konfliktin administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.

Me këtë KONKLuzion të njohohen:


- Arhiva
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Palët


AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS  
KOMISIONI

Valon PRESTREPI  
Kryetar

  
Ahmet KRASNIQI  
Zv. Kryetar

  
Fatime HAZIRI  
Anëtare

  
Shaqir MORINA  
Anëtar

  
Muhamed KRASNIQI  
Anëtar